

VENDIM
Nr.692, datë 18.6.2009

**PËR FINANCIMIN E URDHËRIT TË INFERMIERIT ME NJË GRANT, PËR NJË
PERIUDHË NJËVJEÇARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.9718, datë 19.4.2007 “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, për një periudhë njëvjeçare, të urdhrit të infermierit, me një grant 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha